



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA E KOSOVES
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

547117
12.02.18

PRISHTINE - PRISTINA

PSH.nr.547/17

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik: “HIB PETROL” sh.p.k. – Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me karburante dhe propan butan për nevojat e FSK-së”, me nr.prokurimi: 217-17-5243-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – /Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK)/, më datë: 02.02.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “HIB PETROL” sh.p.k. - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me karburante dhe propan butan për nevojat e FSK-së”, me nr.prokurimi: 217-17-5243-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Forcës së Sigurisë.

II. OBLIGOHET, autoriteti kontraktues /Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK)/, ti bëjë ndryshimet në dosje të tenderit, dhe të veproj konform nenit 53.7 të LPP-së, lidhur me aktivitetin të prokurimit “Furnizim me karburante dhe propan butan për nevojat e FSK-së”, me nr.prokurimi: 217-17-5243-111.

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “HIB PETROL” sh.p.k – Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 27.12.2017.

Hapja e ofertave është bërë me dt: 10.01.2018,

Kundër kritereve të dosjes se tenderit operatorët ekonomik: “HIB PETROL” sh.p.k – Prishtinë, me dt: 20.12.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 22.12.2017, autoriteti kontraktues ka marr vendim dhe hedhur poshtë kërkesën për rishqyrtim e operatorit ekonomik: “HIB PETROL” sh.p.k – Prishtinë

Operatori ekonomik ankues: “HIB PETROL” sh.p.k – Prishtinë si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 29 Dhjetor 2017, me nr. 547/17, kundër kritereve të dosjes së tenderit me titull: “Furnizim me karburante dhe propan butan për nevojat e FSK-së”, me nr.prokurimi: 217-17-5243-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Forcës së Sigurisë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, të LPP-së, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 41, 42, 44 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 10.01.2018, ka autorizuar ekspertin shqyrtues- profesional, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 24.01.2018, në lidhje me pretendimet ankimore të OE "HIB PETROL" – Prishtinë ka sqaruar: Lidhur me pretendimin ankimor të OE-se ankuese, se AK-"Ministria e Forcës së Sigurisë", ka shkelur dispozitat e Neneve: 1 dhe 7 të LPP-se, Eksperti shqyrtues, konstaton këto pretendime ankimore janë të bazuara. Lidhur me pretendimin ankimor të OE-se ankuese, se AK-"Ministria e Forcës së Sigurisë", ka shkelur dispozitat e Neneve 41;42 dhe 44 të RRUOPP-se, eksperti shqyrtues, konstaton këto pretendime ankimore janë të pa bazuara sepse në lenden e trajtuar nga eksperti nuk është gjetur ndonjë shkrese e AK-se që ka bërë shkelje të këtyre neneve pasi që ky aktivitet nuk ka arrit ende në fazën e vlerësimit. Lidhur me pretendimin ankimor të OE-se ankuese, se AK- Ministria e Forcës së Sigurisë, ka bërë shkelje në dosjen e tenderit gjegjësisht në Aneksin 7 Tabela për llogaritjen e çmimit kushtues të karburanteve, ku OE -ankuese pretendon se pika 2 Premium i rafinerisë dhe pika 8 çmimi i transportit, paraqesin diskriminim të Operatoreve Ekonomik. Eksperti shqyrtues konstaton se Premiumi i rafinerisë dhe transporti për litër nuk mund domosdoshmërisht të jetë për të gjithë Operatorët ekonomik i njëjtë, këto pika të pretenduara nga OE ankues mund të jenë me kosto të ndryshme varësisht prej cilit vend importohen karburantet prej Operatorëve ekonomik. Eksperti shqyrtues mendon se ky pretendim i OE-se ankuese është i qëndrueshëm Nëse këto pika të lartë përmendura mbesin në formën e kalkulimit për llogaritjen e çmimeve kushtuese sikurse në Aneksin 7 të DT, atëherë mund të ketë diskriminim ndaj OE-ve pasi që kjo tabelë (Aneksi 7 DT) detyron Operatorët ekonomik që Premiumi i rafinerisë dhe çmimi i transportit për litër të jete për të gjithë OE-te i njëjtë pavarësisht prej nga e importojnë karburantet, gjë që kjo është në kundërshtim me Nenin 1 dhe 7 të LPP-së. Eksperti shqyrtues bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues (AK) — Ministria e Forcës së Sigurisë, për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me karburante dhe propan butan për nevojat e FSK-se dhe MFSK-se të ndara në dy pjesë Pjesa 1 "Furnizim me karburante (diesel dhe benzine) për nevojat e FSK-se dhe MFSK-se" Pjesa 2 Furnizim me propan butan (gaze) për nevojat e FSK-se , me numër të prokurimit të brendshëm: 21700/17/127/111 dhe numër të E-prokurimit: 217-17-5243-1-1-1,, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-se. Eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që AK të bëjë përmirësimet në DT respektivisht në Aneksin 7, dhe të vazhdohet me procedura të mëtutjeshme ndërsa ankesën e OE ankues ta aprovoj si pjesërisht të bazuar.

Operatori ekonomik ankues "HIB PETROL" sh.p.k. - Prishtinë, me datë: 27.01.2018, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 02.02.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i OE ankues, vëzhgues nga OJQ D+ znj. Sara Zhubi, eksperti i

OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z.Xhaferi deklaroj:

Kompania Hib Petrol ka bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, e njëjta është refuzuar e pabazuar dhe në afat kohorë kemi parashtruar ankesë në OSHP lidhur me pretendimet ankimore të cilat janë prezantuar edhe në ankesë. Nuk do lëshohem në detaje, pajtohem në tërësi me mendimin e ekspertit.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-KEK z.Tahiri deklaroj:

Sa i përket raportit të ekspertizës, për ne nuk është problem se a ndërrohen tabelat apo mbesin të njëjta pasi kemi marr ato nga AQP, andaj në këtë aspekt pajtohem me mendimin e ekspertit dhe publikimi i ardhëm do bëhet sipas tabelave të AQP.

Arsyeja pse kërkojmë nga paneli shqyrtues të lejoj AK-në të ritenderoj këtë lëndë, është se në platformën elektronike është lëshuar një gabim teknik, sepse është bërë zgjatja e afati për dorëzim të ofertave dhe hapje në njoftim për korrigjim të gabimeve dhe në dosje, kurse në platformë ka mbet koha e njëjtë e hapjes do thotë 26.12.2017.

Ne kemi kërkuar informata edhe nga KRPP dhe na kanë njoftuar se kjo procedurë nuk mund të vazhdohet më tutje me qenë se ka filluar dorëzimi i ofertave elektronike.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues z.Sopi deklaroj :

Me qenë se dy përfaqësuesit pajtohen me raportin e ekspertizës nuk kam çka të shtoj më shumë. Qëndroj pranë raportit të ekspertizës dhe konstatimeve të dhëna në ekspertizë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE z. Xhaferi deklaroj:

Ne qëndrojmë pranë ankesës dhe ekspertizës dhe kërkojmë që dosja të përmirësohet dhe të eliminohen gabimet në dosje.

Sa i përket afatit për dorëzim, ne jemi të gatshëm në çdo kohë të ofertojmë andaj kjo i mbetet panelit të vendos.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK z.Tahiri deklaroj:

Ne pajtohem me propozimet e ekspertit mirëpo kërkojmë të ritenderohet lënda pasi është e pamundur përmes E Prokurimit të vazhdohet afati, të përmirësohet dosja dhe të barten gjitha rekomandimet e ekspertit të datës 24.01.2018 me nr.547/17.

Në fjalën përfundimtare eksperti shqyrtues z.Sopi deklaroj:

Qëndroj pranë raportit të datës 24.01.2018 si dhe pranë konstatimeve e rekomandimeve të dhëna në raport.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se është i qëndrueshëm pretendimi i OE ankues se autoriteti kontraktues tek aneksi 7 tabela për llogaritjen e çmimit kushtues të karburanteve konkretisht pika 2-premiumi rafinerisë dhe pika 8- çmimi i transportit paraqesin diskriminim për operatorët ekonomik. Prandaj obligohet autoriteti kontraktues gjatë përmirësimit të dosjes të ketë parasysh këtë fakt dhe ndryshimet që bëhen mos të jenë diskriminuese/favorizuese për ndonjë operator ekonomik por të merret parasysh neni 7 i LPP- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - "Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës"

1x1 OE - "HIB PETROL" sh.p.k. – Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.